



A.nr.567/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malësore Gashi-Bajraktari-anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.567/2026 të datës 25.05.2026 të parashtruar nga ankuesja F.G-D të cilën me autorizim e përfaqëson av. Mehdi Geci kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës Veriore në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa më A.nr.567/2026, e datës 25.05.2026, e parashtruar nga ankuesja F.G-D **ashtu** që lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent respektivisht tek Drejtori për Zhvillimin Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Mitrovicës Veriore.

II. Anulohen, Vendimi nr.01-030/01-0001328/26 datë 30.01.2026 i Kryetarit të Komunës si dhe Vendimi nr.13-030/01-0007603/26 i Drejtorisë për Zhvillimin Ekonomik dhe Turizëm i datës 07.05.2026 të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Vendimi nr.01-01-0007932/26, i datës 15.04.2026 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, sipas pikës I të këtij diapozitiv në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Nëpunësja civile F.G-D(në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesja) më datë 25.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër 13-030/01-0007603/26 të datës 07.05.2026 të Drejtoreshës së Drejtorisë Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm si dhe Vendimit nr.01-030/01-0007932/26 datë 14.05.2026 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, për mos konfirmimin e periudhës provuese gjegjësisht ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.06.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek KMV ndërsa, kjo e fundit, më datë 11.06.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2455/2026 të datës 25.05.2026 të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër 01-030/01-0013367/25 të datës 15.08.2025; Konkursin e datës 21.05.2025; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë të datës 26.02.2025; Vendimin me numër 01-030/01-0001328/26 të datës 30.01.2026 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut; Vendimin me numër 13-030/01-0007603/26 të datës 07.05.2026 të Drejtoreshës së Drejtorisë për Zhvillimin Ekonomik dhe Turizëm; Autorizimin e avokatit lidhur me përfaqësimin e ankueses; Raportet ditore të ankueses lidhur me punën e kryer sipas përshkrimit të detyrave të punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.06.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 11.06.2026; Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja sipas konkursit të datës 21.05.2025 me RN00017881 dhe Akt Emërimit me numër protokoli 01-030/07-0013367/25, të datës 15.08.2025, ka themeluar marrëdhënie punë në pozitën ‘Zyrtar për Zhvillim Socio-ekonomik’ në Sektorin për Buxhet dhe Financa në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Më tej Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, përmes vendimit me numër protokoli nr.01-030/01-0007932/26 të datës 15.05.2026, ankueses i ndërpret marrëdhënies e punës në shërbimin civil, me arsyetim se nga ana e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë është bërë vlerësim negativ i punës në periudhën provuese.

Ankuesja, e pakënaqur me vendimin me numër protokoli nr.13-030/01-0007603/26, të datës 07.05.2026 të Drejtoreshës në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm si dhe vendimit me nr.01-030/01-0007932/25 të datës 14.05.2026, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, me datë 25.05.2026 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimet në fjalë kanë shkelje flagrante të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbim civil të Republikës së Kosovës, ku mos konfirmimi i marrëdhënies së punës përkatësisht ndërprerja nga marrëdhënia e punës pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë arsyetim Komuna e Mitrovicës së Veriut i ka pamundësuar ankueses realizimin e të drejtave të saj te garantuara në Kushtetutë dhe ligjet e Kosovës.

Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit të veprimeve të KMV bazuar në Ligjin Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 86 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se “Shqyrtimi administrativ sipas detyrës zyrtare 1. *Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.* 2. *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*” ka konstatuar nga shkresat e lëndës se ankuesja ka themeluar marrëdhënien e punës me KMV me datë 15.08.2025 ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e ka vlerësuar për periudhën nga data 15.08.2026 deri më datë 04.12.2026, sepse është bërë ndryshimi i mbikëqyrësit të ankueses (për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe ndryshimit të pushtetit komunal), bazuar në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrat Publike Drejtorja e Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik lidhur me vlerësimin e datës 04.12.2026 ka vepruar drejt, sepse e njëjta ka përfunduar mandatin, andaj ky veprim është në harmoni me nenin 52 paragrafi 9. *Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse.*

Tutje nga shkresat e lëndës Kryetari i komunës në KMV me datë 30.01.2026 ka nxjerrë vendim me të cilën ankueses i ka zgjatur periudhën provuese deri më datë 15.05.2026 me arsyen se për shkak të ndërrimit të pushtetit lokal ka qenë e pa mundur të bëhet vlerësimi objektiv. Ankuesja akt emërimin e ka nënshkruar me datë 15.08.2025 e cila periudhën provuese prej 6 muaj do të kishte përmbyll me datë 15.02.2026, ndërsa Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore ka marrë pozitën me datë 05.12.2025, po ashtu marrë parasysh se nga data 15.08.2025 deri datë 04.12.2025 ankuesja ka qenë e vlerësuar pozitiv dhe i është konfirmuar marrëdhënia e punës për kohën që është vlerësuar, në bindjen e Kolegjit Drejtorja e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në KMV me vendimin e datës 07.05.2026 ka vepruar në kundërshtim me LZP neni 51 paragrafi 4 dhe 5 nën paragrafi 5.1, 5.2 ku përcaktohet se “ **Para përfundimit të periudhës provuese, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e rezultateve të punës për këtë periudhë.** 5. *Në fund të periudhës provuese, mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunëses/it, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë vendos: 5.1. konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunëses/it në shërbimin civil; 5.2. zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunëses/it, sepse ankuesja nuk ka mbikëqyrës Kryetarin e Komunës së Mitrovicës Veriore por e ka mbikëqyrës Drejtoreshën për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm.*

Ndërsa sa i përket, vlerësimit të punës nga ana e mbikëqyrësit të ankueses të datës 17.04.2026, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë me rastin e marrjes së vendimit të datës 07.05.2026, nuk e ka specifikuar sakt se cilat detyra të punës nuk janë përmbushur nga ankuesja, cilat obligime të punës janë shkelur, e njëjta nuk ka arrit me ndonjë prove të argumentoj se ankuesja ka treguar performancë të pakënaqshme lidhur me punën të cilës po ashtu nuk i është dhënë asnjëherë ndonjë vërejtje me gojë, ndërsa në provat e lëndës eksitojnë prova materiale për kryerjen e detyrave të punës nga ana e ankueses e cila po ashtu për punën e kryer ka raportuar çdo herë, prandaj nisur nga ajo që është thënë më lartë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka bërë vlerësimin në harmoni me nenin 51 paragrafi 1,2,4,5, nën paragrafi 5.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike ku përcaktohet se “ *Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët.* 2. *Gjatë periudhës provuese, nëpunësja/i kryen*

trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë.4.Para përfundimit të periudhës provuese, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e rezultateve të punës për këtë periudhë. 5. Në fund të periudhës provuese, mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunëses/it, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë vendos:1. konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunëses/it në shërbimin civil, sepse nga shkresat e lëndës ankuesja nuk është vlerësuar për punët e kryera, raportet e dorëzuar dhe se nuk ka asnjë shkresë me të cilën ankues i rekomandohet të kryej një veprim ose mos veprim e të cilën ankuesja të mos e ketë përmbushur, prandaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji i Këshillit konstaton se Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Mitrovicës Veriore, ka qenë e obliguar që të ndjekë hapat ligjor të përshkruar në dispozitat e lartshënuara, por meqë nuk janë ndjekur këto hapa, Kolegji obligon të njëjtën që të bëjë vlerësimin e rezultateve të punë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi me qëllim të rikthimit të ligjshmërisë dhe duke ndjekur hapat ligjor të cilat janë shkelur nga KMV ankuesja të vlerësohet bazuar në shkresat dhe raportet me të cilat ka kryer punën në bazë të përshkrimit të punës dhe detyrave të punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.Nr.567/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit Mehdi Geci;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoreshës në Drejtorinë për Zhvillimin Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.